



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 415/1 prot.

Tiranë, më 17.04.2018

**VENDIM**

**Nr.35, datë 17.04.2018**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT  
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT PARALAJMËRUES TË KOMISIONERIT PËR  
ISH DREJTORITË E BUJQËSISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit të dala në përfundim të procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në 12 ish Drejtoritë e Bujqësisë (Tiranë, Vlorë, Fier, Kukës, Durrës, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Gjirokastrë, Dibër, Lushnjë dhe Berat),

**KONSTATOVA SE:**

Me Vendimin nr. 138, datë 30.12.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim, ka vijuar mbikëqyrja edhe në drejtoritë e bujqësisë në rrethe.

Objekt i mbikëqyrjes kanë qenë veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioneri ka dalë me vendim paralajmërues për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë për çdo subjekt, duke kërkuar zbatimin e detyrave specifike dhe duke vendosur një afat për zbatimin e tyre, shoqëruar me raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku janë analizuar hollësisht të gjitha gjetjet e grupit të punës.

Në përfundim të afatit të lënë për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, gjatë vitit 2017, Komisioneri ka filluar procesin e mbikëqyrjes në vazhdim për të verifikuar zbatimin e vendimeve të paralajmërimit për secilin nga këto institucione.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioneri konstatoi se, nga ana e burimeve njerëzore të subjekteve të mbikëqyrura ishin zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Komisioneri. Nga ana tjetër, rezultuan të pazbatuara dhe u vendos verifikimi i mëtejshëm i detyrave të lëna Departamentit të Administratës Publike, si më poshtë:

**1. Për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit në Drejtorinë e Bujqësisë, njësia përgjegjëse (DAP), në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe nenit 111, 113, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me punonjësit të cilët janë transferuar në pozicione pune jashtë shërbimit civil (pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural), duhet të anulohet aktet e transferimit të punonjësve.**

Në kushtet kur, në Vendimin nr.877, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, është përcaktuar se:

- Pika 9: “Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë2 të AZHBR-së, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”.
- Pika 17: “Për nëpunësit aktualë të AZHBR-së zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar”.

vlerësoj se, shkak i kërimit të Komisionerit, nuk ekziston më. Me futjen e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, njësia përgjegjëse (DAP), nuk ka më detyrimin për anulimin e akteve të transferimit për punonjësit që gëzonin statusin e nëpunësit civil. Në këtë rast, njësia përgjegjëse është rekomanduar që të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi, duke mbajtur parasysh, që nëpunësit e transferuar e gëzojnë statusin e nëpunësit civil që në momentin e deklarimit të tyre pranë drejtorive të bujqësisë përkatëse.

2. *Departamenti i Administratës Publike të konfirmojë nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, duke mbajtur parasysh edhe rekomandimin që për çdo procedurë që ka lidhje me menaxhimin e shërbimit civil, të bëhet administrimi i tyre edhe në mënyrë shkresore sipas kërkesave të ligjit, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil.*

Drejtoritë e bujqësisë janë krijuar dhe kanë ushtruar veprimtarinë e tyre bazuar në Vendimin nr. 960, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e drejtorive të bujqësisë”. Këshilli i Ministrave, me Vendimin Nr. 147, datë 13.03.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor”, në pikat 1, 15 dhe 16 të tij, ka vendosur:

“1. Krijimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor si persona juridikë publikë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, me seli në Shkodër, Tiranë, Lushnje dhe Korçë. ....

15. Drejtoritë e bujqësisë të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në momentin e krijimit dhe fillimit të funksionimit të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor Shkodër, Tiranë, Lushnje dhe Korçë.

16. Vendimi nr. 960, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e drejtorive të bujqësisë”, shfuqizohet.”

Nga përmbajtja e dispozitave të sipërcituara, konkludoj se ndodhemi në kushtet e mbylljes apo ristrukturimit të institucionit (në këtë rast, të drejtorive të bujqësisë) dhe krijimit të institucioneve të reja.

Bazuar në Vendimin Nr. 142, datë 12.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, kreu IV “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni, hartohen përshkrimet e reja të punës. Për këtë arsye, çmoj se detyra e lënë Departamentit të Administratës Publike që të konfirmojë nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës për punonjësit që ushtronin detyrat në pozicione pune të shërbimit civil në drejtoritë e bujqësisë, nuk mund të verifikohet më tej.

Në kushtet kur, objekti i kërkimit të Komisionerit ka rënë për shkaqet ligjore të arsyetuara më sipër, vlerësoj se nuk ka më vend për verifikim të mëtejshëm të zbatimit të vendimeve të paralajmërimit të Komisionerit Nr. 158, datë 13.12.2016, për Drejtorinë e Bujqësisë Kukës, Nr. 162, datë 27.12.2016, për Drejtorinë e Bujqësisë Shkodër, Nr. 163, datë 27.12.2016, për Drejtorinë e Bujqësisë Vlorë, Nr. 164, datë 27.12.2016, për

Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë, Nr. 168, datë 30.12.2016, për Drejtorinë e Bujqësisë Dibër, Nr. 174, datë 30.12.2016, për Drejtorinë e Bujqësisë Gjirokastrë, Nr. 5, datë 31.01.2017, për Drejtorinë e Bujqësisë Fier, Nr. 34, datë 16.02.2017, për Drejtorinë e Bujqësisë Durrës, Nr. 36, datë 17.02.2017, për Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan, Nr. 42, datë 28.02.2017, për Drejtorinë e Bujqësisë Lezhë, Nr. 125, datë 26.05.2017, për Drejtorinë e Bujqësisë Berat dhe Nr. 166, datë 18.07.2017, për Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimeve Nr. 158, datë 13.12.2016, në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës, Nr. 162, datë 27.12.2016, në Drejtorinë e Bujqësisë Shkodër, Nr. 163, datë 27.12.2016, në Drejtorinë e Bujqësisë Vlorë, Nr. 164, datë 27.12.2016, në Drejtorinë e Bujqësisë Tiranë, Nr. 168, datë 30.12.2016, në Drejtorinë e Bujqësisë Dibër, Nr. 174, datë 30.12.2016, në Drejtorinë e Bujqësisë Gjirokastrë, Nr. 5, datë 31.01.2017, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier, Nr. 34, datë 16.02.2017, në Drejtorinë e Bujqësisë Durrës, Nr. 36, datë 17.02.2017, në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan, Nr. 42, datë 28.02.2017, në Drejtorinë e Bujqësisë Lezhë, Nr. 125, datë 26.05.2017, në Drejtorinë e Bujqësisë Berat dhe Nr. 166, datë 18.07.2017, në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje.
2. Për këtë vendim të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**